



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë,01.06.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 27.05.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "N.P.G Malsija", për aktivitetin: "Furnizimi, prodhimi dhe vendosja e numrave të adresave në Komunën e Prishtinës Nr. të Prok: 616 21 058 111 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "N.P.G Malsija" e datës 17.05.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, prodhimi dhe vendosja e numrave të adresave në Komunën e Prishtinës Nr. të Prok: 616 21 058 111 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, të datës 20.04.2021 dhe të korigjimeve të datës 13.05.2021, të publikuara në web-faqe të KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë aktivitetin me korigjimet që do të bëhen sipas disa pretendimeve të bazuara .
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "N.P.G Malsija" me datë 27.05.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizimi, prodhimi dhe vendosja e numrave të adresave në Komunën e Prishtinës Nr. të Prok: 616 21 058 111**

Zyrtari përgjegjës i prokurimit duke u bazuar në faktin se pretendimet janë krejtësisht teknike ka kërkuar nga Njësia e Kërkesës-Drejtoria për Urbanizim përgjegjët në të njëjtat dhe sipas zyrtareve Drejtoria në këtë kërkesës tuajën janë përshirë pretendimet nga kërkesa e

kaluar e datës 17.05.2021 dhe lidhur me kete i keni marre pergjegjet me datën 18.05.2021.Ua përkujtojmë pergjegjet nga Vendimi paraprak:

“1.OE duhet te ofroj dëshmi te mjaftueshme se ka realizuar kontrata për furnizime te ngjashme (Numra te objekteve Banesave Zyrove) ne tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit te njoftimit për kontrate ne shumen se paku 60,000.00 Euro., Kjo kërkesë është ne kundërshtim me LPP-ne pasi qe duhet te pranohen referenca për pune te ngjashme si shenjat vertikale , shenjat për emërtimet e rrugëve etj. qe janë 100% me material te njëjtë me standarde te njëjta dhe kane qëllime te njëjta . Kërkojmë qe pranohen edhe referencat për punët e ngjashme si shenjat vertikale, tabela te ndryshme etj. ?! - Pas shqyrtimit të kërkesës suaj, do e marrim parasysh këtë kërkesë dhe do pranohen edhe punët tjera të ngjashme si : Sinjalizimi vertikal, Emërtimet rrugore etj...

2. OE duhet te sjell certifikatën e Konfirmimit nga 3M. Certifikata duhet te jete valide, Originali ose kopje e noterizuar ? Kjo kërkesë është ne kundërshtim me LPP-ne dhe me sqarimet tjera te bëra nga AK, pasi qe është përcaktuar vetëm prodhuesi 3M ndërsa ne sqarimet tjera dhe ne dosje është lejuar edhe prodhime te tjera si ORAFOL , andaj kërkojmë qe largohet përcaktimi i vetëm një prodhuesit dhe njeherit te mjaftoje vetëm kopja e certifikatës pasi AK e ka mundësinë e verifikimit oleinë ne çdo kohe dhe pa asnjë angazhim shtese? - Të nderuar ashtu siç e kemi përmendur edhe në sqarimet e tjera, nuk e kemi favorizuar vetëm një prodhues përkundër kësaj ne kemi dalluar jashtë kushteve të përcaktuara me UA – të adresave ku përcaktohet vetëm 3M. Ne kemi sqaruar se duhet patjetër të ketë CERTIFIKATEN E KONFIRMIMIT nga 3M ose ORAFOL ose e ngjashme, që duhet të jetë Original se kopje e noterizuar.

3. OE duhet te sjell certifikatën ISO 7591:1982, certifikata duhet te jete valide., Originali ose kopje e certifikatës se noterizuar dhe duhet te sillen dëshmi qe lëshuesi i kësaj certifikate është i akredituar për lëshimin e kësaj certifikate. Kjo dëshmi duhet te jete e noterizuar. Kjo kërkesë është ne kundërshtim me LPP-ne, njëkohësisht kjo kërkesë është krejt e pakuptimte dhe e panevojshme pasi qe ky standard është për tabela te automjeteve dhe nuk ka te beje fare me projektin e ne fjale. Kjo kërkesë duhet te largohet menjëherë pasi qe kjo kërkesë përbenë elemente te veprës penale pasi qe njësia e kërkesës me vetëdije te plote ka vendos kritere duke e favorizuar hapur OE te caktuar te njohur për ne) dhe njëkohësisht duke përjashtuar OE te tjerë për faktin qe ky standarde nuk ka asnjë Lidhje me tenderin ne fjale. - Këtë pikë mund ta marrim si gjysmë të plotë, sa i përket që ky standard është për tabela të automjeteve, por nëse e lexojmë ISO standardin në fjalë janë po të njëjta kërkesa që kemi kërkuar ne për këtë projekt. Më poshtë gjene likun me specifikat që kërkohen në këtë standard dhe mund të bëni krahasimin me Specifikacionet tona. D.m.th. Të ketë jetëgjatësi, të jetë rezistent ndaj temperaturave, të mos jetë kancerogjen, të jetë rezistent ndaj ujit, të pastrohet lehtë, të jetë pa krom etj. <https://docs.google.com/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZGVmYXVsdGRvbWFpbnpbnRyYW5ldHpkcnxneDo1MjI0YzRkMTlmNDQ1MDEy> P.S. Certifikata mundet të mos jetë e domosdoshme mirëpo, Specifikacionet teknike patjetër që po.

4. OE duhet to ofroj certifikatën ISO 14001, OHSAS 18001-2007 dhe ISO 9001 2015 nder te tjera edhe për veprimtarinë për stampim, Certifikata duhet te jete valide., Originali ose kopje e noterizuar dhe duhet te sillen dëshmi q lëshuesi i kësaj certifikate është i akredituar për lëshimin e kësaj certifikate. Kjo dëshmi duhet te jete e noterizuar.

Kjo kërkesë është në kundërshtim me LPP-ne dhe me sqarimet e KRPP-se, pasi që nuk ka asnjë logjikë të kërkohej ISO STANDARD për niob proces të prodhimit dhe jo për prodhimin në tërësi si dhe dëshmia e akreditimit të trupit akreditues. Kjo kërkesë është përshtatur në një OE të caktuar (të njohur edhe për ne) dhe kjo përshtatje është shkelje e rëndë e LPP-se dhe kërkojmë që këto kërkesa që favorizojnë hapur një OE të caktuar dhe diskriminojnë hapur OE , që duke i përshtatur në detaje kushtet e tenderit X -OE , është tentim për kufizim të pjesëmarrësve tjerë dhe njëkohësisht tentim për keqpërdorim të buxhetit publik pasi që dihet saktë se cila kompani apo OE i ka këto certifikata dhe AK po përpriqet që përmes këtyre sqarimeve të fundit në mënyrë perfide të bëjë veprime të kundërligjshme për qëllime të përfitimeve në kundërshtim me Ligjin . - Të nderuar kjo akuzë e juaja është e pa bazë dhe pa kuptim, nga kjo mësojmë se nuk janë lexuar kushtet e kërkuara nga ana e juaj dhe nuk kemi njohuri se qfarë përmbajnë këto standarde. Më poshtë do japim sqarime edhe një herë se çka përmbajnë dhe cili është qëllimi i tyre: • ISO 14001: 2015 – është certifikatë ose standard mjedisor, pasi që siç kemi kërkuar Numërtim i brendshëm, d.m.th këto numërtime do të vendosen në ambiente/ hapësira të brendshme dhe nuk lejohet të kenë ndikime anësore të dëmshme për personat të cilët jetojnë, veprojnë në ato ambiente. • OHSAS 18001-2007 - shërben si dëshmi që produktet janë ekologjike dhe nuk ndikojnë në shëndet. Kjo certifikatë pas datës 30.09.2021, nuk vlen pasi që do të ndryshohet në ISO 45001, andaj OE që tashmë janë certifikuar me ISO 45001 kanë përparësi. • Certifikata 9001:2015 – (shërben si dëshmi për stampim), pasi që numrat duhet të jenë të stampuar. Andaj edhe kërkohej specifika tjera dhe dëshmi tjera më të veçanta dhe jo sikur : Sinjalizimi vertikal, emërtimet rrugore etj., ku këto vendosen në hapësira të jashtme dhe nuk kanë ndikim. Bazuar në këto përgjegje konstatoj se janë pranuar pjesërisht dy pretendimet tuaja ato lidhur me referencat e kërkuara dhe me certifikatën ISO 7591:1982,e cila mund të zëvendësohet me ndonjë dëshmi tjetër se produkti është në harmoni me specifikimet teknike.”

Nga përmbajtja e Vendimit rrjedh se janë dhene përgjegjet adekuate në pretendimet tuaja dhe vlejné të njëjtat edhe për kërkesën e tashme.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në sqarimet paraprake konstaton se pretendimet tuaja në këto rast janë të pa bazuara dhe ka vendosur si në dispozitiv

Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës , departamentit të prokurimit dhe njësis së kërkesës.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit